

Universitetit “Eqrem Çabej” realizimin me sukses të misioneve të tij e sheh të lidhur ngushtë me procesin e **ndërkombëtarizimit**, dimension i vlerësuar si një prioritet zhvillimor me qëllim: “Zgjerimin dhe forcimin e të gjithë formave të bashkëpunimit ndërkombëtarë me IAL, me institucione kërkimore-shkencore, agjencitë e zhvillimit, ne funksion te realizimit te programeve të përbashkëta, nxitjes së programeve të mobilitetit, pjesëmarrjes në projektet europiane etj”. Në këtë vështrim projektit **QUADIC** vjen si një mekanizëm I dobishëm në procesin e transformimit të tyre në institucione të hapura ndaj standartit dhe pritshmërive.

**QUADIC** është project I Erasmus + CBHE (Capacity building of higher education), ngritje kapacitetesh të institucioneve të arsimit të lartë. Projekti filloi në vitin 2020 dhe do të përfundojë në shtator 2023. Në vijim të plan-aktiviteteve, gjatë ditëve 26 shkurt deri 2 mars në Universitetin “Kadri Zeka” të Gjilanit, Kosovë, u zhvillua trajnimi prej partnerëve europianë (Universiteti “Cote d’Azur ”( Nisë) dhe Peruxhia (Itali), mbi nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtare dhe mobiliteteve.



Ky trajnim u realizua në përputhje me aktivitetet e paketës së punës W.P.5.2. Ndër tematikat e trajtuara ishin: Mobilitet ndërkombëtare; Skema e fondeve Europiane për organizimin e mobiliteteve për target grupe të ndryshme ( akademik, administrative dhe studentor), Promovimi I mobiliteteve ndërkombëtare etj.